



Më
 Data 10. 11. 2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me procesmbajtëse-praktikanten Fikrije Kamberi , në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] , i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.24-3/15 me datë 12.04.2017, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr. PP/II.nr.24-3/15 me datë 12.04.2017për dhënien e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.05.06.2017 mori këtë :

AKT GJYKIM

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.24-3/15 me datë 12.04.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë :

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] me vendbanim ne fshatin [REDACTED] i lindur me datë [REDACTED] në fshatin [REDACTED] nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED] gjinis [REDACTED], punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike shqiptar ,shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit [REDACTED],mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Se me datën 08.01.2015 rreth orës 14:50 në fshatin Lloshkobare Komuna Ferizaj duke drejtuar automjetin e markës “Fiat Punto” ngjyre te zezë me targa te regjistrimit [REDACTED] nga pakujdesia e ne kundërshtim me nenin 71.1 te LKSRR-së ka rrezikuar trafikun publik ,jetën e njerëzve dhe pasurin e tyre në atë mënyrë qe ka bërë kalimin e qerres me kalë e cila ishte duke lëvizur në drejtimin e njëjte ,gjatë ketijë veprimi humb kontrollin mbi timonin ,dhe me anësoren përparme të anës së djathtë godet njesin dy-qerre në mes ,ku si pasoj e goditjes te dy njësit humbin kontrollen dhe dalin jashtë rrugës në anën e djathtë me ç’ rast përveç dëmeve materiale

lëndime te lehta trupore pëson drejtuesi i njësisë dy-qerres, [REDAKTUAR] të përshkruar si në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 04.03.2017.

-me të cilën ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 60.88(gjashtëdhjet e tetëdhjetë e tetë cent) në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.24-3/15 me datë 12,04,2017ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.24-3/15 me datë 12,04,2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: konstatimi i ekspertit mjeko ligjor i datës 04.03.2017, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 15.03.2017 raportet mjeksore nga QKMF-Ferizaj dhe Qendres Emergjente në Prishtinë të datës 08.01.2015 si dhe fotografitë në shkresat e lëndëve , vërteton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Konform nenit 458,459 dhe 460 I dëmtuari [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20(njëzet euro) si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 60.88(gjashtëdhjet e tetëdhjetë e tetë cent) në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.882/17 datë 05.06.2017

Procesmbajtëse
Fikrije Kamberi

Gjyqtarja Individuale
Hakile Ilazi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.